REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIAROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10977 prot. Roskovec,më 27.12.2022

**VENDIM**

**Nr. 97 Datë 23.12.2022**

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË ROSKOVEC DHE TË NDËRRMARJEVE VARTËSE, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 54 shkronja "ç" të Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore",të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore",të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.350, datë 19.4.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin",të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 175 datë 8.3.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar" të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore" të ndryshuar,Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.187 datë 8.3.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve,zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike" të ndryshuar,Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.604 datë 14.9.2022 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

1. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe të Ndërmarrjeve Vartëse për vitin 2023" sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.

2. Efektet financiare në paga dhe sigurime shoqërore do të përballohen nga fondi përkatës në buxhetin e vitit 2023.

3. Ky vendim i shtrin efektet jurdiko-financiare nga data 01.01.2023.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës e Bashkisë Roskovec si dhe Sektorët e Financës të dy ndërmarrjeve vartëse.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**
**Kadri Hyska**